

VENDIM
Nr.232, datë 23.3.2011

**PËR MIRATIMIN E FUNKSIONEVE TË STRUKTURAVE PËRGJEGJËSE NË
SEKTORIN MINERAR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 30, 43 pika 6, e 56, pika 1 të ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 36/1 të ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Strukturat përgjegjëse për dhënien e lejeve minerare, mbikëqyrjen dhe monitorimin e veprimtarive minerare në zbatim të ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, janë:

- a) Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN).
- b) Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH).
- c) Reparti i Inspektim-Shpëtimit të Minierave (RISHM).

ç) Drejtoria përkatëse në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës që trajton problemet e veprimtarisë minerare.

- d) Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL).

2. Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) ka këto detyra:

a) Hartimin e hartave për veprimtaritë minerare për shfrytëzimin e mineraleve të Republikës së Shqipërisë, pjesë e programit të veprimit 3-vjeçar të strategjisë minerare, dhe zonimin e planit vjetor minerar.

b) Hartimin e hartave të zonave të rrezikut minerar për zonat minerare të Republikës së Shqipërisë.

c) Pranimin, regjistrimin dhe publikimin në *web site* të datës e të orës së kërkesës për aktverifikimin e lejes së shfrytëzimit ose të lejes së kërkim-zbulim-shfrytëzimit për zonat e hapura.

ç) Shqyrtimin e miratimit të zonës së rrezikut minerar dhe të çdo kërkesë për të drejtë minerare gjatë miratimit të projektit të zhvillimit të veprimtarisë minerare;

d) Shqyrtimin e plotësimit të kushteve të dhënies së lejes së shfrytëzimit dhe dokumenteve vërtetuese për kërkesat për zonat e hapura dhe fituesit e procedurës së konkurrimit publik, të renditura më poshtë:

- i) realizon aktin e verifikimit të lejeve të shfrytëzimit;
- ii) realizon aktin e verifikimit të lejeve të kërkim-zbulim-shfrytëzimit;

iii) vlerëson projektin e zhvillimit të veprimtarive minerare të shfrytëzimit dhe bën oponencën e tij;

iv) vlerëson projektin e rehabilitimit të zonës minerare që përfshin, projektin e veprimtarive të mbylljes, projektin e menaxhimit të mbetjeve minerare, projektin e rehabilitimit progresiv e minerar të zonës minerare;

v) vlerëson vlerat e garancive financiare për realizimin e programit të investimit dhe realizimin e planit të rehabilitimit të zonës minerare dhe përgatit aktin e miratimit të ministrit për këto garanci;

vi) bën oponencën dhe harton vendimin e këshillit teknik, që nënshkruhet nga titullari i institucionit dhe sekretari, e cila duhet të përmbajë miratimin ose mosmiratimin për projektin e zhvillimit të veprimtarive minerare dhe planit të rehabilitimit, si dhe vlerat e garancive financiare për realizimin e programit të investimit dhe realizimin e planit të rehabilitimit të zonës minerare dhe e dërgon atë në METE brenda afateve kohore të miratuara me vendim të Këshillit të

Ministrave.

dh) Mbikëqyrjen për respektimin nga titullari i lejes së kushteve të lejes dhe të normave të detyrueshme të legjislacionit në fuqi për veprimtarinë minerare.

e) Raportimin për kontrollin e zbatimit të këtij ligji për lejet minerare të shfrytëzimit.

ë) Mbështetjen e ministrit për përgatitjen e politikave e të programeve në fushën minerare për:

i) drejtimet për zhvillimin e sektorit minerar;

ii) promovimin e zonave minerare, për të cilat do të jepen lejet minerare të shfrytëzimit, përmes procesit të konkurrimit apo procedurave të hapura;

iii) promovimin e zonave minerare për shfrytëzim, mbështetur në hartën minerare digjitale, e cila hartohet brenda 1 (një) viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji dhe përditësohet vazhdimisht;

iv) parashikimin e përgjithshëm të produktit vjetor në sektorin minerar;

v) programimin e veprimtarive të shfrytëzimit të mineraleve;

vi) nevojat për zhvillimin e burimeve njerëzore, profesionale në veprimtaritë minerare;

vii) rregullat për mbrojtjen e mjedisit, peizazhit dhe rehabilitimin e tij;

viii) tabelën me vlerat minimale të sipërfaqes së zonës së lejuar të lejeve minerare të shfrytëzimit sipas grupimeve të mineraleve, vlerën minimale të investimit për lejet minerare të shfrytëzimit, si dhe vlerat minimale të prodhimit të mineralit, për zonat konkurruese dhe zonat e hapura, sipas grupeve të mineraleve.

f) Monitorimin minerar e postminerar të minierave të mbyllura dhe në regjim konservimi.

g) Mbikëqyrjen dhe monitorimin e depozitimeve të mbetjeve minerare të minierave në veprimtari shfrytëzimi, të braktisura, të mbyllura dhe në regjim konservimi.

gj) Shqyrtimin e planeve vjetore të veprimtarisë minerare të shfrytëzimit për çdo leje minerare.

h) Hartimin dhe paraqitjen ministrit, çdo 3 (tre) muaj, të një raporti, i cili përmban të dhëna për:

i) realizimin e prodhimit;

ii) realizimin e investimeve;

iii) vlerën e produkteve të shitura;

iv) vlerën e punimeve minerare të realizuara;

v) vlerën e operacioneve të kryera për rehabilitimin e mjedisit dhe menaxhimin e mbetjeve minerare.

i) Hartimin dhe paraqitje ministrit, çdo 6 (gjashtë) muaj, të një raporti për çdo veprimtari minerare shfrytëzimi, i cili përmban të dhëna për:

i) respektimin e realizimit të projektit minerar;

ii) realizimin e operacioneve e të punimeve minerare dhe depozitimin e mbetjeve minerare;

iii) lëvizjen e rezervave minerare;

iv) kryerjen e operacioneve minerare në përputhje me normat e ruajtjes së mjedisit minerar, duke u këshilluar me autoritetet e qeverisjes vendore të zonës minerare.

j) Propozimin ministrit për masat e penalitetet që duhet të ndërmerren ndaj subjekteve minerare që nuk respektojnë kërkesat e legjislacionit minerar mbi bazën e rezultateve të mbikëqyrjes dhe të monitorimit të veprimtarive minerare.

3. Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) ka të drejtë:

a) të kryejë inspektime për ndjekjen e respektimit të dispozitave të këtij ligji, të lërë detyra, të marrë masa administrative apo të propozojë marrjen e tyre nga ministri, si pezullimin e punimeve të veprimtarisë minerare deri në ndalimin e veprimtarisë minerare dhe heqjen e licencës së ushtrimit të profesionit;

b) të kërkojë informacion nga zotëruesi i lejes sa herë vlerëson se ai përdor praktika të dëmshme shfrytëzimi të mineraleve dhe të trajtimit të tyre, për respektimin e standardeve

mjedisore të pranuara sipas legjislacionit në fuqi, apo se ai i drejton operacionet e punës në kundërshtim me ato të parashikuara në projektin e miratuar, si dhe çdo të dhënë tjetër, për të llogaritur detyrimet financiare, që ka zotëruesi sipas këtij ligji.

4. Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH) ka këto detyra:

a) Hartimin e hartave të veprimtarive minerare për kërkim-zbulimin e mineraleve në Republikën e Shqipërisë, pjesë e programit të veprimit 3-vjeçar të strategjisë minerare, dhe zonimin e planit vjetor minerar.

b) Pranimin, regjistrimin dhe publikimin në *web site* të datës dhe orës së kërkesës për aktverifikimin e lejes së kërkim-zbulimit për zonat e hapura.

c) Shqyrtimin e plotësimit të kushteve të dhënies së lejes së kërkim-zbulimit për kërkesat për zonat e hapura dhe fituesit e procedurës së konkurrimit publik, si më poshtë vijon:

i) realizon aktin e verifikimit për lejet e kërkim-zbulimit;

ii) vlerëson projektin e zhvillimit të veprimtarive minerare të kërkim-zbulimit dhe programin minimal të punës për kërkim-zbulimin dhe bën oponencën e tij;

iii) vlerëson projektin e rehabilitimit të zonës minerare, që përfshin projektin e veprimtarive të mbylljes, projektin e menaxhimit të mbetjeve minerare, projektin e rehabilitimit progresiv e minerar të zonës minerare;

iv) vlerëson vlerat e garancive financiare për realizimin e programit minimal të punës për lejet e kërkim-zbulimit dhe realizimin e planit të rehabilitimit të zonës minerare dhe përgatit aktin e miratimit të ministrit për këto garanci;

v) bën oponencën dhe harton vendimin e këshillit teknik, që nënshkruhet nga titullari i institucionit dhe sekretari, që duhet të përmbajë miratimin ose mosmiratimin për projektin e zhvillimit të veprimtarive minerare e të planit të rehabilitimit, si dhe vlerat e garancive financiare për realizimin e programit minimal të punës për lejet e kërkim-zbulimit dhe realizimin e planit të rehabilitimit të zonës minerare.

ç) Mbikëqyrjen e respektimit nga titullari i lejes të kushteve të lejes së kërkim-zbulimit dhe të normave të detyrueshme të legjislacionit në fuqi për veprimtarinë minerare.

d) Raportimin për kontrollin e zbatimit të këtij ligji për lejet minerare të kërkim-zbulimit.

dh) Mbështetjen e ministrit për përgatitjen e politikave e të programeve në fushën minerare për:

i) drejtimet për zhvillimin e sektorit minerar;

ii) promovimin e zonave minerare, për të cilat do të jepen lejet minerare të kërkim-zbulimit, përmes procesit të konkurrimit apo procedurave të hapura;

iii) promovimin e zonave minerare për kërkim-zbulim, mbështetur në hartën minerare digjitale, e cila hartohet brenda 1 (një) viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji dhe përditësohet vazhdimisht;

iv) programimin e veprimtarive të kërkimeve themelore gjeologjike;

v) nevojat për zhvillimin e burimeve njerëzore, profesionale në veprimtaritë minerare;

vi) rregullat për mbrojtjen e mjedisit, peizazhit dhe rehabilitimin e tij;

vii) tabelën me vlerat minimale të sipërfaqes së zonës së lejuar të lejeve minerare të kërkim-zbulimit, vlerën minimale të investimit për lejet minerare të kërkim-zbulimit sipas grupeve të mineraleve.

e) Shqyrtimin e planeve vjetore të veprimtarisë minerare të kërkim-zbulimit.

ë) Hartimin dhe paraqitjen ministrit, çdo 3 (tre) muaj, të një raporti, i cili përmban të dhëna për:

i) realizimin e investimeve;

ii) vlerën e punimeve minerare të kërkim-zbulimit të realizuara;

iii) vlerën e operacioneve të kryera për rehabilitimin e mjedisit dhe menaxhimin e mbetjeve minerare;

f) Hartimin dhe paraqitjen ministrit, çdo 6 (gjashtë) muaj, të një raporti për çdo

veprimtari minerare kërkim-zbulimi, i cili përmban të dhëna për:

- i) respektimin e realizimit të projektit mineral;
- ii) realizimin e operacioneve e të punimeve minerare dhe depozitimin e mbetjeve minerare (nëse ka);
- iii) vlerësimin e rezervave minerare të zbuluara;
- iv) kryerjen e operacioneve minerare në përputhje me normat e ruajtjes së mjedisit mineral, duke u këshilluar me autoritetet e qeverisjes vendore të zonës minerare.

5. Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH) ka të drejtë:

a) të kryejë inspektime për ndjekjen e respektimit të dispozitave të këtij ligji, të lërë detyra, të marrë masa administrative apo të propozojë marrjen e tyre nga ministri, si pezullimin e punimeve të veprimtarisë minerare deri në ndalimin e veprimtarisë minerare, heqjen e licencës së ushtrimit të profesionit;

b) të kërkojë informacion nga zotëruesi i lejes sa herë vlerëson që ai përdor praktika të dëmshme të kërkim-zbulimit të mineraleve, për respektimin e standardeve mjedisore të pranura sipas legjislacionit në fuqi, apo se ai i drejton operacionet e punës në kundërshtim me ato të parashikuara në projektin e miratuar, si dhe çdo të dhënë tjetër, për të llogaritur detyrimet financiare, që ka zotëruesi sipas këtij ligji.

6. Reparti i Inspektim-Shpëtimit të Minierave (RISHM) ka këto detyra:

a) Bashkëpunimin me institucionin e AKBN-së për hartimin e hartave të zonave të rrezikut mineral për zonat minerare të Republikës së Shqipërisë.

b) Kontrollin e respektimit nga titullari i lejes të kushteve të lejes dhe të normave të detyrueshme të sigurisë në punë e të mbrojtjes së shëndetit të punonjësve për veprimtaritë minerare sipas legjislacionit në fuqi për veprimtarinë minerare dhe atij të punës.

c) Mbështetjen e ministrit për përgatitjen e politikave e të programeve në fushën minerare për:

i) rregullat për zbatimin e masave për sigurinë në punë dhe sigurinë e punonjësve për veprimtaritë minerare;

ii) rregullat për mbrojtjen e mjedisit, peizazhit dhe rehabilitimin e tij.

ç) Respektimin e rregullave të sigurisë në vendet e depozitimeve të mbetjeve minerare në veprimtaritë minerare.

d) Hartimin dhe paraqitjen ministrit, çdo 6 (gjashtë) muaj, të një raporti për çdo veprimtari minerare kërkim-zbulimi, shfrytëzimi ose kërkim-zbulimi-shfrytëzimi, i cili përmban të dhëna për:

i) respektimin e kërkesave të sigurisë në veprimtaritë minerare, sigurisë në punë të punonjësve dhe rregullave për mbrojtjen e shëndetit të punonjësve, duke dhënë edhe rekomandimet përkatëse;

ii) respektimin e rregullave të sigurisë në vendet e depozitimeve të mbetjeve minerare.

7. Reparti i Inspektim-Shpëtimit të Minierave (RISHM) ka të drejtë:

a) të kryejë inspektime për ndjekjen e respektimit të dispozitave të këtij ligji, të lërë detyra, të marrë masa administrative apo të propozojë marrjen e tyre nga ministri, si pezullimin e punimeve të veprimtarisë minerare deri në ndalimin e veprimtarisë minerare, heqjen e licencave të përcaktuara me ligj ose me vendim të Këshillit të Ministrave për trajtim nga ky institucion;

b) të kërkojë informacion nga zotëruesi i lejes sa herë vlerëson se ai përdor praktika të dëmshme kërkim-zbulimi apo shfrytëzimi të mineraleve dhe të trajtimit të tyre, në kundërshtim me standardet dhe kërkesat e sigurisë në veprimtaritë minerare, sigurisë në punë të punonjësve dhe rregullave për mbrojtjen e shëndetit të punonjësve, të parashikuara në projektin e miratuar dhe në përputhje me detyrimet që ka zotëruesi sipas këtij ligji.

8. Drejtoria përkatëse në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës që trajton problemet e veprimtarisë minerare ka këto detyra:

a) Mbështetjen e ministrit për përgatitjen e politikave e të programeve në fushën minerare për:

- i) drejtimet për zhvillimin e sektorit mineral;
- ii) hartimin e legjislacionit primar dhe atij sekondar për veprimtaritë minerare;
- iii) hartimin e monitorimit të strategjive të zhvillimit të sektorit mineral;
- iv) promovimin e zonave minerare, për të cilat do të jepen lejet minerare, përmes procesit të konkurrencës apo procedurave të hapura;
- v) promovimin e zonave minerare, mbështetur në hartën minerare digjitale, e cila hartohet brenda 1 (një) viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji dhe përditësohet vazhdimisht;
- vi) diskutimin e programit të zhvillimit të veprimtarive minerare e të planit vjetor mineral me institucionet e tjera.

b) Hartimin dhe paraqitjen ministrit, çdo 6 (gjashtë) muaj, të një raporti përmbledhës për veprimtarinë minerare në vend, bazuar në përmbajtjen e raporteve të tri strukturave: AKBN, SHGJSH, RISHM, i cili përmban të dhëna për:

- i) ecurinë e veprimtarive minerare nëpërmjet plotësimit të indikatorëve vlerësues;
- ii) lëvizjen e rezervave minerare;
- iii) gjendjen e mjedisit mineral;
- iv) respektimin e standardeve të sigurisë në punë e të mbrojtjes së shëndetit të punonjësve;

- v) respektimin e rregullave të sigurisë në vendet e depozitimeve të mbetjeve minerare.

c) Organizmin e konkurrencës publik për zonat konkurruese duke realizuar:

- i) shpalljen e zonave minerare që kalojnë në konkurrencë publik;
- ii) vlerësimin e kriterëve teknike dhe financiarë për subjektet konkurruese;
- iii) shpalljen e fituesit për të drejtën e aplikimit të lejes minerare.

9. Drejtoria përkatëse në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, që trajton problemet e veprimtarisë minerare, ka të drejtë:

a) të kërkojë nga institucionet e AKBN-së, SHGJSH-së, RISHM-së të kryejnë inspektime për ndjekjen e respektimit të dispozitave ligjore, të lërë detyra për to për rastet kur ka ankesa, të bëjë vlerësime për moszbatim të ligjit, të marrë masa administrative apo të propozojë marrjen e tyre nga ministri;

b) të kërkojë nga institucionet e AKBN-së, SHGJSH-së, RISHM-së e QKL-së të respektojnë afatet procedurale për dhënien e të drejtave minerare për ndjekjen e respektimit të dispozitave të këtij ligji, të kërkojë përgjigje për rastet kur ka ankesa, vlerësime për moszbatim të ligjit;

c) të kërkojë informacion nga institucionet e AKBN-së, SHGJSH-së, RISHM-së e QKL-së, sa herë ka dyshime se prej tyre ka shkelje të rregullave të përcaktuara në këtë ligj.

10. Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) ka për detyrë:

a) pranimin e dokumentacionit të plotë për aplikimet e lejeve minerare në bazë të plotësimit të kushteve, kriterëve dhe dokumentacionit përkatës të dhënies së lejes së kërkim-zbulimit, shfrytëzimit ose kërkim-zbulimit-shfrytëzimit në përputhje me kërkesat e ligjit mineral dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij për fituesit e konkurrencës publik për lejet minerare në zonat konkurruese dhe ato të aplikuesve për zonat e hapura.

b) vënien në dispozicion të institucioneve shqyrtuese, AKBN dhe SHGJSH, të dokumentacionit të plotë të aplikimit për leje minerare;

c) përcjelljen në mënyrë elektronike për procedurë miratimi ose refuzimi të dokumentacionit të paraqitur për vlerësim dhe oponencë në METE;

d) hartimin dhe paraqitjen ministrit, çdo 3 (tre) muaj, të një raporti për ecurinë e aplikimeve për leje minerare pranë këtij institucioni;

e) sigurimin e këshillimit për ministrin për përgatitjen e politikave e të akteve ligjore në fushën e lejeve/licencave.

11. Forma e funksionimit dhe organizimi i këtyre strukturave përcaktohen me ligj ose me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave.

12. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij

vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha